

Udhëzime rreth hyrjes dhe kthimit në Schleswig-Holstein

Çka duhet të kenë parasysh udhëtarët ?

Në përgjithësi rekomandohet, që për shkak të Corona-Pandemisë të gjithë udhëtarët që vijnë nga vendet e huaja, pamarrë parasysh nga cili vend, duhet të kontaktojnë me Entin Shëndetësor lokal, për tu sqaruar nese kërkohen masa të mëtejshme.

E rëndësishme është, që ju para se të ktheheni të verifikohet nese ju ktheheni nga një zonë e rrezikut. Për zonat e rrezikut të brendshëm si dhe për përjashtimet, mund ti gjeni te faqja e internetit së Ministrisë së Shëndetësisë (www.schleswig-holstein.de/msgjfs), ndërsa për zonat e rrezikut jashtë vendit, mund ti gjeni në faqet e internetit të Robert Koch-Instituts (www.rki.de).

Për te gjithë ata udhëtar që kthehen nga zonat e rrezikut në Schleswig-Holstein **duhet të zbatohen rregullat në vijim:**

- ➔ Drejtperdrejtë në shtëpi ose në ndonjë akomodim tjetër të pershtatshem.
- ➔ Kontaktoni Entin Shëndetësor lokal për tu informuar mbi udhëtimin.
- ➔ Bëni një test falas, nëse departamenti i shëndetësisë pas hyrjes e bën këtë të detyrueshëm. (Test i detyrueshëm)
- ➔ Për simptomat që tregojnë një infeksion me Koronavirus, menjehere të informohet Enti Shëndetësor lokal.
- ➔ Në shtëpi, ose në ndonjë akomodim tjetër, 14 ditë të qëndroni në Karantinë. Në këtë kohë nuk lejohen vizitat nga persona të tjerë, përpos familjarëve.



ose

Për mundësinë që të shkurtoni karantinën 14-ditore, duhet të paraqisni dy teste negative të koronës para departamentit lokal të shëndetit.

- Këto teste janë për Ju falas.
- Pas hyrjes mundeni për këtë stacionet për prova ti përdorni.
- Vini re se midis marrjes së materialit të mostrës për provën e parë dhe asaj të dytë, duhet të ketë të paktën pesë ditë ndërmjet.
- Nëse përpara se të hyni në vend keni bërë një provë të parë, atëherë midis rezultatit të provës dhe hyrjes nuk duhet të kenë kaluar më shumë se 48 orë.
- Gjithashtu materiali i mostrës të paktën njëra nga të dy testet të merret më së herrshmi pesë ditë pas hyrjes.
- E rëndësishme: Detyrimi i karantinës vlen derisa të jenë të dy rezultatet e testeve negativ në dispozicion. Informacione të mëtejshme dhe detaje të kontaktit për autoritetet lokale shëndetësore mund ti gjeni këtu: www.schleswig-holstein.de/coronavirus-einreise

Në rast të shkeljeve të masave mbrojtëse në përputhje me paragrafin 3 të rregullave shtetërore mbi masat për karantinë (vetizolimi) mund të shqiptohen gjobat:

Shkelje	Gjobë
Nëse jeni kthyer nga udhëtimi nga zonat e rrezikut dhe nëse i shkelni rregullat e karantinimit për 14 ditë si në shtëpinë tuaj ose në ndonjë strehim tjetër të pershtatshem...	500 € - 10.000 €
Nëse jeni kthyer nga udhëtimi prej zonave të rrezikut dhe nuk shkonit direkt në shtëpinë tuaj ose në ndonjë strehim tjetër të pershtatshem...	150 € - 3.000 €
Nëse ju përkunder sigurimit të karantines (vetizolimit) pas kthimit nga udhëtimi prej zonave të rrezikut, pranoni vizitor...	300 € - 5.000 €
Nëse ju nuk lajmëroheni menjehere në Entin Shëndetësor përkatës pas kthimit nga zonat e rrezikut...	150 € - 2.000 €
Nëse ju udhëtoni për në Schleswig-Holstein dhe rruga e juaj tranzitore ka qenë nëpër një zonë rrezikur dhe nuk jeni larguar direkt...	150 € - 3.000 €
Nëse ju pas kthimit nga udhëtimi keni simptoma të koronës dhe nuk lajmëroheni menjehere në Entin Shëndetësor, gjithashtu edhe nëse simptomat shfaqen më pas...	300 € - 3.000 €